



Pranuar / Dorëzuar Punëhënë / Prodato Received / Delivery	07.11.2023	3	vite / vite years
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojtja Puneg Appendix	Sasia Këmbja Quantity
SAMSHTUK	6911/2023		1/2



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1213/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1213/2023 të datës 26.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] në Gjakovë, kundër organit të punësimit, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.11.2023 mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1213/2023 të datës 26.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted].

A r s y e t i m

Ankuesi, [redacted] me datë 26.09.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6266/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me koeficientin e pagës sipas Akt emërimit me numër 03/1269 të datës 31.08.2023.

Në proces të shqyrtimit të ankesës nga Këshilli ankuesi më datë 01.11.2023 përmes shkresës/kërkesës me numër protokollit 6804/2023, ka tërhequr ankesën A.nr.1213/2023 të datës 26.09.2023, me arsyetimin se i njëjti ka parashtruar ankesë të re me pretendime dhe prova të reja lidhur me çështjen ankimore.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës me numër protokollit 6804/2023 të parashtruar nga ankuesi për tërheqje nga ankesa, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për





Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1119/2023 të datës 28.08.2023, si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1213/2023.

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

